

ALEAT sh.p.k.

**Raporti i Auditorit te Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare per vitin e
mbyllur me 31 dhjetor 2010**

Permbajtja:

	Faqja
Raporti i Auditorit te Pavarur	
Pasqyra e pozicionit financiar	2
Pasqyra e te ardhurave gjithepefshirese	3
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital	4
Pasqyra e flukseve te parase	5
Shenime per pasqyrat financiare	6 - 33

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Aksionarëve dhe drejtuesve të Aleat Sh.p.k.

Raporti mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Aleat Sh.p.k. bashkëngjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2010 dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo pasaktësive.

Përgjegjësia e Auditorit


Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojnë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethanat të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Aleat Sh.p.k. më 31 dhjetor 2010 si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.




Tirana, Albania
28 shkurt 2011

ALEAT sh.p.k.
Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2010
(Shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

	Shenime	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
AKTIVET			
Aktive afatgjata			
Aktive jo-materiale	6	1,822,142,192	2,495,477,671
Aktive tatimore te shtyra	7	12,021,687	13,304,343
		1,834,163,879	2,508,782,014
Aktive afatshkurtra			
Inventare	8	460,185,132	387,804,138
Kerkesa per t'u arketuar	9	265,597,992	530,543,748
Parapagime dhe te tjera per t'u arketuar	10	21,085,151	15,669,935
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente	11	1,354,992,853	239,420,965
		2,101,861,128	1,173,438,786
Totali i aktiveve		3,936,025,007	3,682,220,800
KAPITALI NETO			
Kapitali i nenshkruar	12	619,750,000	619,750,000
Kapitali i nenshkruar i papaguar	12	-	(100,000)
Fitime te akumuluar		1,365,553,618	2,445,461
		1,985,303,618	622,095,461
DETYRIME			
Detyrime afatgjata			
Provizione	13	37,467,900	-
Huate	14	58,488,690	759,895,708
		99,956,590	759,895,708
Detyrime afatshkurtra			
Detyrime per t'u paguar (riklasifikuar)	15	448,303,517	781,394,368
Te tjera detyrime (riklasifikuar)	16	61,674,148	137,122,286
Tatim fitimi i pagueshem	17	126,366,771	17,420,964
Te ardhura te shtyra	18	464,696,190	460,487,400
Tarife koncesioni	19	49,334,271	191,662,860
Huate	14	704,389,902	712,141,753
		1,854,764,799	2,300,229,631
Totali i detyrimeve		1,950,721,389	3,060,125,339
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		3,936,025,007	3,682,220,800

Keto pasqyra financiare jane autorizuar per publikim nga drejtuesit e shoqerise ALEAT sh.p.k. me 28 shkurt 2011 dhe u nenshkruan ne emer te tyre nga:


 Jean-Alain JOUAN Aleat
 Drejtori i pergjithshem ekzekutiv


 Elton TORO
 Drejtori i departamentit te finances

Pasqyra e pozicionit financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare nga faqja 6 deri ne faqen 33, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

ALEAT sh.p.k.

Pasqyra te ardhurave gjithepershireshe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

	Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2009
Te ardhurat			
Shitje	20	6,175,202,100	3,833,257,200
Te ardhura te tjera	21	404,966,502	-
		6,580,168,602	3,833,257,200
Shpenzimet			
Lende te para	22	(3,156,717,620)	(2,213,423,297)
Furnizime dhe sherbime	23	(470,664,667)	(393,111,272)
Shpenzime konçesioni	24	(308,760,105)	(191,662,860)
Shpenzime personeli	25	(289,072,455)	(404,043,068)
Amortizimi	6	(699,934,007)	(445,357,171)
Zhvleresimi i te arketueshmeve	9	(13,657,081)	-
Provizione	13	(37,157,155)	-
Te ardhura (shpenzime) te tjera, neto (riklasifikuar)	26	1,895,275	(99,591,296)
		(4,974,067,815)	(3,747,188,964)
Fitimi nga veprimtaria kryesore		1,606,100,787	86,068,236
Te ardhura financiare (riklasifikuar)	27	18,309,374	7,681,491
Shpenzime financiare	27	(106,867,393)	(28,522,268)
Shpenzime financiare, neto		(88,558,019)	(20,840,777)
Fitimi para tatimit mbi fitimin		1,517,542,768	65,227,459
Tatim mbi fitimin	28	(154,434,611)	(10,240,549)
Fitimi per vitin		1,363,108,157	54,986,910
Te ardhura te tjera gjithepeshireshe		-	-
Totali i te ardhurave per vitin		1,363,108,157	54,986,910

Pasqyra e te ardhurave gjithepershireshe duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare nga faqja 6 deri ne faqen 33, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

ALEAT sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

	Kapitali aksioner	Kapitali i nenshkruar i papaguar	Fitime (humbje) te akumuluar	Totali
Gjendja me 1 janar 2009	619,750,000	(103,931,282)	(52,541,449)	463,277,269
Pagesa te kapitalit	-	103,831,282	-	103,831,282
Fitimi i vitit	-	-	54,986,910	54,986,910
Gjendja me 31 dhjetor 2009	619,750,000	(100,000)	2,445,461	622,095,461
Pagesa te kapitalit	-	100,000	-	100,000
Fitimi i vitit	-	-	1,363,108,157	1,363,108,157
Gjendja me 31 dhjetor 2010	619,750,000	-	1,365,553,618	1,985,303,618

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare nga faqja 6 deri ne faqen 33, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

ALEAT sh.p.k.
Pasqyra e flukseve te parase per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010
(Shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

	Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2009
Flukset e parase nga veprimtarite operacionale			
Fitimi para tatim fitimit		1,517,542,768	65,227,459
Rregullime per:			
Amortizimi	6	699,934,007	445,357,171
Fitimi neto nga shitja e aktiveve jo-materiale	29	(814,676)	-
Tarife konçesioni e perllogaritur	24	308,760,105	191,662,860
Te ardhura te kompensuara me tarifa konçesioni te pagueshme	21	(367,013,055)	-
Zhvlersimi i kerkesave per t'u arketuar	9	13,657,081	-
Provizione	13	37,467,900	-
Efkti i amortizimit te kosos se huave		-	(3,547,408)
Shpenzime per interesa	27	104,217,243	23,932,871
Te ardhura nga interesat	27	(13,164,341)	(6,168,645)
		2,300,587,032	716,464,308
Ndryshim ne aktivet dhe pasivet operative:			
Rritje ne inventare		(72,380,994)	(387,804,138)
Pakesim (rritje) ne kerkesa per t'u arketuar		251,288,675	(530,543,748)
Pakesim (rritje) ne parapagimet dhe te tjera per t'u arketuar		(4,493,566)	46,762,290
(Pakesim) rritje ne detyrimet per t'u paguar		(333,090,852)	721,088,852
(Pakesim) rritje ne detyrimet e tjera		(75,448,138)	135,154,580
(Pakesim) rritje ne te ardhurat e shtyra		(80,788,500)	460,487,400
		1,985,673,659	1,161,609,544
Tatimi mbi fitimin i paguar	17	(44,206,148)	(2,350,000)
Paraja neto gjeneruar nga aktiviteti operacional		1,941,467,511	1,159,259,544
Flukset e parase nga veprimtarite investuese			
Arketimet nga shitja e aktiveve	29	6,867,120	-
Blerje e aktiveve te jo-materiale	6	(32,650,972)	(2,369,222,817)
Interesi i arketuar		13,164,341	6,168,645
Paraja neto perdorur ne veprimtarite investuese		(12,619,511)	(2,363,054,172)
Fluksi i parase nga veprimtarite financuese			
Arketimet nga pagesa e kapitalit	12	100,000	-
Arketimet nga huate		92,204	1,753,300,036
Pagesa per huate		(701,864,275)	(291,084,370)
Interesi i paguar		(111,604,041)	(58,207,794)
Paraja neto (perdorur ne) gjeneruar nga veprimtarite e financimit		(813,276,112)	1,404,007,872
Rritja neto ne mjete monetare dhe te tjera ekuivalente te saj		1,115,571,888	200,213,244
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente ne fillim te vitit		239,420,965	39,207,721
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente ne fund te vitit		1,354,992,853	239,420,965

Pasqyra e flukseve te parase duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare ne faqet 6 deri ne 33, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

1 Te pergjithshme

1.1 Informacion i pergjithshem mbi Shoqerine

ALEAT sh.p.k. ("ALEAT "ose "Shoqeria"), eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar me Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR) me 18 gusht 2008 me NIPT K82018015V.

Aktiviteti i Shoqerise konsiston ne zbatimin e Marreveshjes se Sherbimit te Konçesionit ('Marreveshja e Konçesionit') nenshkruar me Qeverine Shqiptare ('Autoriteti') per prodhimin dhe shperndarjen e dokumentave te identifikimit dhe pasaportave elektronike dhe ne aktivite te tjera te lidhura me zbatimin e marreveshjes se konçesionit si: rikonstrukcion, sherbime te teknologjise se komunikimit dhe informacionit, themelimin dhe manaxhimin e nje rrjeti zyresh te ngritura per pranimin e aplikimeve per karta identiteti dhe pasaporta, perpunimin e te dhenave, printimin dhe shperndarjen e kartave te identitetit dhe pasaportave, etj. Marreveshja e Konçesionit hyri ne fuqi me 27 korrik 2008 ('Data Efektive') dhe pritet te perfundoje me 31 korrik 2013.

ALEAT eshte nje kompani e cila zoterohet nga Morpho (me pare njohur me emrin Sagem Sécurité) dhe Albanian-American Enterprise Fund (AAEF) dhe ka strukturen e meposhtme te kapitalit:

Emri i aksionarit	%
Morpho – France	75%
Albanian-American Enterprise Fund – USA	25%
Total	100%

Shoqeria meme perfundimtare e Shoqerise eshte SAFRAN Group.

Sipas kushteve te Marreveshjes se Konçesionit, AAEF dhe Morpho do te jene aksioneret e vetem te Shoqerise pergjate periudhes se konçesionit dhe ne rast transferimi te aksioneve ndermjet njeri-tjetrit, Morpho do te zoteroje te pakten 50.1% te aksioneve me te drejte vote.

Kapitali i regjistruar i Shoqerise me 31 dhjetor 2010 eshte 619,750,000 Lek (2009: 619,750,000 Lek).

Drejtori i pergjithshem ekzekutiv i Shoqerise eshte Z. Jean-Alain Jouan i emeruar dhe i regjistruar bazuar ne vendimin e QKR nr. 21671/1, date 21 tetor 2008.

Shoqeria ka adresen e saj te regjistruar ne rrugen "Qemal Stafa" (ish Tipografia Ushtarake).

Me 31 dhjetor 2010 numri i punonjesve ishte 361 (31 Dhjetor 2009: 353).

1.2 Marreveshja e Konçesionit – kushte te rendesishme

Pershkrimi

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9663, date 18 dhjetor 2006 "Mbi konçesionet" dhe Ligjin Nr. 8952, date 10 tetor 2002 "Mbi pajisjen me pasaporta te qytetareve shqiptare" ashtu si dhe Vendimet e Keshillit te Ministrave Nr. 541, date 26 korrik 2006; Nr. 27, date 19 janar 2007; Nr. 253, date 27 prill 2007; Nr. 715, date 6 nentor 2007; Nr. 196, date 13 prill 2007 dhe Nr. 525, date 8 gusht 2007 ne lidhje me pajisjen me mjete identifikimi dhe pasaporta te qytetareve shqiptare, Qeveria shqiptare perfaqesuar nga Ministria e Brendshme ('Autoriteti') lidhen nje Marreveshje Konçesionit me Shoqerine (Konçesionari) me 27 Korrik 2008.

Ne perputhje me kushtet e caktuara ne Marreveshje, Ministria e Brendshme financon dhe autorizon Konçesionarin per te ofruar sherbimet e dizenjimit, themelimit, zhvillimit, implementimit dhe operimit te sistemit per ofrimin e kartave te identitetit dhe pasaportave qytetareve dhe ose rezidenteve te tjere ne Shqiperi.

1 Te pergjithshme (vazhdim)

1.2 Marreveshja e Konçesionit – kushte te rendesishme (vazhdim)

Nje Amendim i Marreveshjes se Konçesionit (“Amendimi”) u nenshkrua me Autoritetin me 13 korrik 2010, u aprovua nga Parlamenti Shqiptar me 23 shtator 2010 dhe eshte efektiv duke filluar nga data 5 nentor 2010. Ne baze te Amendimit, Autoriteti pranoi te paguaje per sherbimet e reja (“Sherbimet e reja”) dhe te kompensoje per sherbimet shtese te kryera ne 2009 pertej objektit te Marreveshjes origjinale (“Sherbimet e Kryera”).

Ne perputhje me Marreveshjen, Shoqeria do te realizoje sherbimet e saj sipas menyres se meposhtme:

- a) Do te instaloje infrastrukturen dhe sistemet per pergatitjen e kartave te identitetit dhe pasaportave te cilat perfshijne sistemet e Aplikimit dhe Regjistrimit; Manaxhimit te te dhenave biometrike; Kontrollit te Cilesise; Transportit dhe Leshimit; Personalizimit; dhe sistemin e Infrastruktures se Autoritetit te Çertifikimit.
- b) Ngritjen e nje Ambjenti Qendror per Personalizimin ne nje zone te ofruar nga Autoriteti nepermjet rikonstruksionit fizik, rregullimeve te kushteve te sigurise si dhe perdorimit te teknologjise ashtu siç eshte rene dakord ne kushtet e Marreveshjes dhe Amendimit.
- c) Ngritja e nje rrjeti te zyrave te Aplikimit ne zona te vena ne dispozicion nga Autoriteti me personel te kualifikuar si dhe me pajisje te pershtatshme aplikimi dhe regjistrimi per dokumentat e identifikimit ne perputhje me kushtet e Marreveshjes dhe Amendimit.
- d) Ngritja e nje ndertese per ruajtjen e te dhenave e cila te sherbeje si nje arkive e sigurt per te gjitha te dhenat.
- e) Dizenjimi, implementimi, dhe operimi me nje sistem te plote dhe te integruar software i cili do te mbeshtese te gjitha proceset e siperpermendura si ne nivel lokal (ne zyrat e aplikimeve) ashtu dhe ne nivel qendror (Ambjenti Qendror per Personalizimin).

Ne perputhje me Amendimin, Shoqeria do te ofroje edhe “Sherbimet e reja” si me poshte:

- a) Dizenjimin, ngritjen, zhvillimin, implementimin dhe operimin e Sistemit per rritjen e kapacitetit te prodhimit dhe shperndarjes se pasaportave ne perputhje me specifikimet e Amendimit.
- b) Dizenjimin, ngritjen, zhvillimin, implementimin dhe operimin e Sistemit per pajisjen me Dokumenta Identifikimi te Emigranteve ne perputhje me specifikimet e Amendimit.
- c) Ngritja e nje rrjeti te Zyrave te Aplikimit ne zyrat konsullore/ambasadat e Republikes se Shqiperise ne vendet e huaja ne perputhje me specifikimet e Amendimit.
- d) Dizenjimin, ngritjen, zhvillimin, implementimin dhe operimin e Sistemit per pajisjen me Pasaporta me Procedure te Pershpejtuar ne perputhje me specifikimet e Amendimit.

Detyrime te tjera te rendesishme te Shoqerise perfshijne:

- Garantimin e shperndarjes se kartave te identitetit dhe pasaportave brenda afateve te caktuara ne Marreveshjen e Konçesionit, ne te cilen parashikohen penalitete ne rast te vonesave te shperndarjes se tyre bazuar ne te dhenat mesatare vjetore.
- Garantimin e nje cilesie te larte dhe besueshmerie te larte pergjate periudhes se konçesionit.
- Garantimin e konfidencialitetit, sigurise dhe integritetit te te dhenave biometrike te mbledhura per qytetaret shqiptar.

Te drejta te tjera te Shoqerise perfshijne:

- Ushtrimin e te gjitha te drejtave, ne lidhje me zoterimin dhe perdorimin pa pagese te ambjenteve te siguruara nga Autoriteti me qellimin e realizimit te objektivave (b) deri ne (d) .
- Negocimi dhe zgjatja e periudhes se konçesionit ne perputhje me kushtet e Marreveshjes.

Detyrimet kryesore te Autoritetit pervec sigurimit te ambjenteve pershkruar me lart perfshijne gjithashtu:

- Marrjen e te gjitha masave te nevojshme per ta bere te detyrueshme pajisjen me karta identiteti per qytetaret shqiptar mbi moshen 16 vjeç.
- Pergjegjesine per venien ne dispozicion te Shoqerise te informacioneve dhe te dhenave te nevojshme per te realizuar objektivat e caktuara ne Marreveshje.

1 Te pergjithshme (vazhdim)

1.2 Marreveshja e Konçesionit – kushte te rendesishme (vazhdim)

Kushte te rendesishme qe mund te prekin shumen, kohezgjatjen, dhe sigurine e flukseve monetare:

- a) Periudha e konçesionit: Konçesioni zgjat per nje periudhe minimale prej 5 vitesh duke filluar nga Data Efektive.
- b) Periudha e Konçesionit mund te zgjatet nese numri i kartave te identitetit dhe pasaportave te shitura nuk arrin numrin minimal te caktuar deri ne fund te kohezgjatjes se Marreveshjes dhe nese kjo nuk vjen si pasoje e veprimeve te Konçesionarit.
- c) Te drejtat e konçesionit duhet te jene eskuzive dhe Konçesionari duhet te kete te drejta eskuzive dhe te vetme te shitjes se kartave te identitetit dhe pasaportave pergjate periudhes se konçesionit.
- d) Çmimi per kartat e identitetit dhe pasaportat, kartat e identitetit per emigrantet, kartat e identitetit qe leshohen nga zyrat e aplikimit ne Ambasade, si dhe dokumentet e sherbimit me procedure te pershpjettuar, eshte i percaktuar ne Marreveshjen me Autoritetin dhe duhet te qendroje fiks pergjate periudhes se konçesionit. Çmimi i parapaguhet Shoqerise.

Dorezimi i konçesionit

Pas perfundimit te Marreveshjes se Konçesionit, Konçesionari duhet te beje dorezimin e ambjenteve te Konçesionit tek Autoriteti. Shoqeria duhet te transferoje tek Autoriteti çdo te drejte apo titull ne lidhje me ambjentet e Konçesionit dhe te gjithë aktivet e dezinjuara dhe te perdorura gjate periudhes se konçesionit. Githashtu, Konçesionari duhet t'i dorezoje Autoritetit, pa asnje tarife apo pagese te metejshme, te gjitha dokumentat dhe te dhenat ne zoterim te tij qe kane lidhje me konçesionin.

Konçesionari duhet te siguroje qe te gjitha aktivet, te drejtat, pronat dhe zerat e tjere referuar ne kete pike te Marreveshjes te cilat do t'i transferohen Autoritetit duhet te jene ne kushte te mira pune dhe te riparuar mire ne menyre qe sistemi te kete mundesi te funksionojë normalisht, per tre vite te tjera pa lindur nevoja per te zevendesuar ndonje pjese, me perjashtim te materialeve te konsumit, dhe pa perdorur asnje detyrim garancie pertej periudhes nje vjecare pas Periudhes se Konçesionit.

Zgjidhja e Marreveshjes

Autoriteti ka te drejte te zgjidhe ne menyre te njeanshme Marreveshjen e Konçesionit nese Shoqeria nuk permbush detyrimet e saj sipas Marreveshjes dhe nese kjo mangesi vazhdon edhe 60 dite pas njoftimit me shkrim per kete shkelje; nese Shoqeria ka probleme me likuiditetin apo nese ka transferim te aksioneve jo ne perputhje me kushtet e Marreveshjes. Nga ana tjetere, Shoqeria ka te drejte te zgjidhe Marreveshjen e Konçesionit nese Autoriteti kryen shkelje te rende te detyrimeve te tij sipas Marreveshjes per nje periudhe me te gjate se 60 dite.

2 Mjedisi ne te cilin vepron Shoqeria

Shqiperia paraqet karakteristika te nje tregu ne rritje me nje inflacion relativisht te qendrueshem. Vendi ka treguar nje rritje ekonomike te qendrueshme ne vitet e fundit.

Paqendrueshmeria e koheve te fundit ne tregjet financiare globale dhe ate shqiptar

Kriza e vazhdueshme globale e likuiditeteve e cila nisi ne mes te vitit 2007 (referuar shpesh si 'Ngerç Financiar') ka çuar, mes te tjerash, ne nivele te ulta te likuiditeteve ne sektorin bankar dhe me gjere, norma me te larta huadhenie dhe politika konservatore ne lidhje me huadheniet. Pasigurite ne tregjet financiare globale kane çuar ne mbylljen/deshtimin e bankave dhe shoqerive te tjera si dhe ne nderhyrje shteterore per shpjetimin e tyre si ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes, Evropen Perendimore, Rusi, etj. Ne fakt, ndikimi i plote i krizes se vazhdueshme financiare po tregon qe eshte e veshtire qe ajo te parashikohet apo izolohet plotesisht.

Ndikimi tek klientet dhe huamarresit

Qytetaret shqiptar jane te vetmit kliente per Shoqerine te cilet mund te preken negativisht nga kriza e vazhdueshme financiare qe mund te ndikojë mbi aftesine e tyre per te paguar.

2 Mjedisi ne te cilin vepron Shoqeria (vazhdim)

Drejtuesit nuk mund te percaktojne me besueshmeri efektet ne pozicionin financiar te Shoqerise te nje perkeqesimi te mundshem ne mjedisin operativ te Shoqerise si rezultat i krizes ne vazhdim. Drejtuesit mendojne se po marrin te gjitha masat e nevojshme per te mbeshtetur qendrueshmerine dhe zhvillimin e Shoqerise ne kushte te tilla.

Drejtuesit mendojne se ndikimi i krizes financiare ne pozicionin financiar te Shoqerise nuk do jete i rendesishem ne vitin e ardhshem.

3 Politika te rendesishme kontabel

Per pergatitjen e ketyre pasqyrave financiare jane perdorur politikat kontabel te meposhtme.

3.1 Bazat e pergatitjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e kostos historike.

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF kerkon perdorimin e disa perlllogaritjeve kontabel te rendesishme. Gjithashtu kerkon nga drejtuesit ushtrimin e gjykimit te tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te Shoqerise. Fushat qe permbajne nje shkalle me te larte gjykimi ose kompleksiteti ose fushat ne te cilat supozimet dhe perlllogaritjet jane te rendesishme ne pasqyrat financiare jane pasqyruar ne Shenimin 5.

3.2 Standardet dhe interpretimet e reja

Disa standarde dhe interpretime te reja jane publikuar te cilat jane te aplikueshme per Shoqerine dhe jane te detyrueshme per periudhat kontabel qe fillojne me ose pas 1 janarit 2010:

(a) Standardet e reja dhe ato te ndryshuara te adoptuara nga Shoqeria

Standardet e reja dhe te ndryshuara ne vazhdim jane te detyrueshme per t'u aplikuar per here te pare per vitin financiar qe fillon me 1 janar 2010.

- SNK 36 (amendim), 'Zhvleresimi i aktiveve', efektiv nga 1 janari 2010. Ndryshimi sqaron se njesia me e madhe gjeneruese e parase (ose grupi i njesive) te e cila duhet alokuar emri i mire per qellime te testimi te zhvleresimit, eshte nje segment shfrytezimi, sic percaktohet ne paragrafin 5 te SNRF 8, 'Segmentet e shfrytezimit' (pra, perpara bashkimit te segmenteve me karakteristika te ngjashme ekonomike).

(b) Standardet dhe ndryshimet e standardeve ekzistuese te meposhtme jane publikuar dhe jane te detyrueshme per t'u aplikuar nga Shoqeria per periudhen qe fillon ne 1 janar 2010 ose me pas dhe ne periudhat ne vazhdim, megjithate adoptimi i tyre nuk ka ndonje efekt ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

- SNRF 3 (i rishikuar), 'Kombinimet e biznesit', dhe ndryshimet e metejshme te SNK 27 'Pasqyrat financiare te konsoliduara dhe individuale', SNK 28 'Investime ne pjesemarrje', dhe SNK 31 'Interesat ne siper marrjet e perbashketa' behen efektive ne menyre prospective ne kombinimet e biznesit per te cilat data e blerjes eshte me ose pas dates se fillimit te periudhes se pare te raportimit vjetor duke filluar nga data 1 korrik 2009 e ne vazhdim. Standardi i rishikuar vazhdon te aplikojte metoden e blerjes ne kombinimet e biznesit, me disa ndryshime te rendesishme ne krahasim me SNRF 3. Per shembull, te gjitha pagesat per blerjen e nje biznesi regjistrohen me vlere te drejte ne daten e blerjes, ku pagesat e kushtezuara klasifikohen si detyrime qe me pas ri-maten nepermjet pasqyres se te ardhurave gjithperfishirese. Ka nje mundesi zgjedhjeje ne çdo blerje per matjen e interesit jo kontrollues tek pala e blere ose me vlere te drejte, ose me pjesen perpjesetimore te interesit te pales jo-kontrolluese ne aktivet neto te pales se blere. Te gjitha kostot qe lidhen me blerjen ngarkohen ne shpenzime

3 Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

3.2 Standardet dhe interpretimet e reja (vazhdim)

- SNK 27 (i rishikuar) kerkon qe efektet e transaksioneve me interesa jo-kontrollues te paqyrohen ne kapital, nese nuk ka ndryshime ne kontroll, dhe te mos rezultojne ne emer te mire apo ne fitime dhe humbje. Standardi gjithashtu specifikon kontabilizimin kur kontrolli humbet. Interesat e mbetura ne shoqeri ri-maten me vlere te drejte, dhe fitimi ose humbja rezultuese njihet ne fitimi ose humbje.
- KIRFN 17, 'Shperndarja e aktiveve jo-monetare per pronaret' (efektive duke filluar me ose pas dates 1 korrik 2009 e ne vazhdim). U publikua ne nentor 2008. Ky interpretim ofron nje udhezues mbi kontabilitetin per marreveshjet ku nje shoqeri shperndan aktive jo-monetare per aksioneret ose si shperndarje te rezervave, ose si dividende. Edhe SNRF 5 ka ndryshuar per te kerkuar qe aktivet te klasifikohen si te mbajtura per t'u shperndare vetem ne rastet kur jane te gatshme per t'u shperndare ne kushtet e tyre aktuale dhe shperndarja ka probabilitet te larte te ndodhe.
- KIRFN 18, 'Transferimi i aktiveve nga klientet', efektive per transferimin e aktiveve nga klientet te marra me ose pas 1 korrikut 2009. Ky interpretim sqaron kerkesat e SNRF-ve mbi marreveshjet ne te cilat nje shoqeri merr nga nje klient nje aktiv afatgjate material qe duhet ta perdore per t'i mundesuar klientit lidhjen ne rrjet ose per t'i siguruar atij akses te vazhdueshem te te mirat ose sherbimet e ofruara (te tilla si pajisja me energji elektrike, gaz apo uje). Ne disa raste, shoqeria merr para nga klienti te cilat mund t'i perdore vetem per te blere ose ndertuar aktive afatgjate materiale, ne menyre qe t'i mundesoje klientit lidhjen ne rrjet ose akses te vazhdueshem te te mirat ose sherbimet e ofruara (ose te dyja bashke).
- KIRFN 9, 'Rivleresimi i instrumentave derivative te perfshire', dhe SNK 39, 'Instrumentet financiare: njohja dhe matja e tyre' efektive nga data 1 korrik 2009. Ky ndryshim ne KIRFN 9 kerkon qe nje shoqeri te vleresoje nese nje derivativ i perfshire duhet paraqitur vecmas nga kontrata baze kur Shoqeria riklasifikon nje aktiv financiar jashte kategorise 'me vleren e drejte permes fitimit apo humbjes'. Ky vleresim behet bazuar ne kushtet qe ekzistonin ne me te vonshmen mes dates ne te cilen shoqeria u be per here te pare pale e kontrates dhe dates se ndonje ndryshimi te kontrates qe ndryshoi ndjeshem flukset monetare kontraktuale. Nese shoqeria nuk eshte ne gjendje ta beje kete vleresim, instrumenti hibrid duhet te mbetet i klasifikuar me vleren e drejte permes humbjes ose fitimit ne teresine e tij
- KIRFN 16, 'Mbrojtja (hedge) e investimit neto ne nje njesi ekonomike te huaj', efektiv nga 1 korriku 2009. Ky ndryshim sqaron se ne mbrojtjen e investimit neto ne nje njesi ekonomike te huaj, instrumentat mbrojtjes te kualifikuar mund te mbahen nga çdo shoqeri brenda grupit, perfshire edhe vete njesine ekonomike te huaj, per sa kohe qe plotesohen kerkesat e SNK 39 mbi percaktimin, dokumentimin dhe efektivitetin qe lidhen me mbrojtjen e investimeve neto. Ne vecanti, shoqeria duhet te dokumentoje ne menyre te qarte strategjine e saj mbrojtese per arsye te mundesise se perkufizimeve te ndryshme ne nivele te ndryshme te grupit.
- SNK 38 (amendim), 'Aktivet jo-materiale', efektiv nga 1 janari 2010. Ndryshimi sqaron udhezimet per matjen e vleres se drejte te nje aktivi jo-material te blere ne nje kombinim biznesi dhe lejon grupimin e aktiveve jo-materiale ne nje te vetem nese kane jetegjatesi ekonomike te ngjashme.
- SNK 1 (amendim), 'Paraqitja e pasqyrave financiare'. Ndryshimi sqaron se shlyerja e mundshme e nje detyrimi permes emetimit te kapitalit, nuk ndikon ne klasifikimin e tij si afatshkurter apo afatgjate. Duke ndryshuar perkufizimin e detyrimit afatshkurter, ndryshimi lejon nje detyrim te klasifikohet si afatgjate (nese shoqeria ka nje te drejte te pakushtezuar per te shtyre shlyerjen permes transferimit te mjeteve monetare apo aktiveve te tjera per te pakten 12 muaj pas periudhes kontabile) pavaresisht faktit qe shoqerise mund ti kerkohet nga palet ta shlyeje ne kapital ne çdo kohe.
- SNFR 2 (amendime), 'Transaksione te pageses te bazuara ne aksione per t'u shlyer ne mjete monetare', efektiv nga 1 janari 2010. Perveç perfshirjes se KIRFN 8, 'Qellimi i SNRF 2', dhe KIRFN 11, 'SNRF 2 –Transaksionet ne grup dhe ne aksione thesari', ndryshimet shtrihen edhe mbi udhezimin e KIRFN 11 per te trajtuar marreveshjet ne grup te cilat nuk mbuloheshin nga ky interpretim.

3 Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

3.2 Standardet dhe interpretimet e reja (vazhdim)

- SNRF 5 (amendim), 'Aktivet afatgjata te mbajtura per shitje dhe operacionet jo te vazhdueshme'. Ndryshimi qarteson se SNRF 5 specifikon shenimet shpjeguese qe kerkohen per aktivet afatgjata (apo grupet) te klasifikuara si te mbajtura per shitje dhe per operacionet jo te vazhdueshme. Gjithashtu qarteson se kerkesat e pergjithshme te SNK 1 jane ende te aplikueshme, veçanerisht paragrafi 15 (per te arritur nje paraqitje te drejte) dhe paragrafi 125 (burimet e vleresimit te pasgurise) te SNK 1.

(c) Standarde te reja, ndryshime dhe interpretime te publikuara por jo efektive per vitin financiar qe fillon me 1 janar 2010 dhe te pazbatuara me pare.

Vleresimi i Shoqerise mbi impaktin e ketyre standardeve te reja dhe interpretimeve eshte si me poshte.

- SNFR 9, 'Instrumentet financiare', botuar ne nentor 2009. Ky standard eshte hapi i pare ne procesin e zevendesimit te SNK 39 'Instrumentet financiare: njohja dhe matja'. SNFR 9 paraqet kerkesat e reja per klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe ka te ngjare te ndikoje trajtimin kontabel te aktiveve financiare te Shoqerise. Standardi eshte efektiv me 1 janar 2013 por eshte i mundur aplikimi ne avance i tij. Shoqeria duhet ende te vleresoje impaktin e plote te SNRF 9.
- SNK 24 i rishikuar 'Informacion shpjeguese mbi palet e lidhura', botuar ne nentor 2009. Ajo zevendeson SNK 24, 'Shenimet shpjeguese mbi palet e lidhura', te publikuar ne vitin 2003. SNK 24 (i rishikuar) eshte i detyrueshem per periudhat qe fillojne me apo pas 1 janarit 2011. Aplikimi me i hershem, i plote apo i pjesshem, eshte i lejuar. Standardi i rishikuar qarteson dhe thjeshteson perkufizimin e paleve te lidhura dhe heq kerkesen per shenime shpjeguese per shoqerite e lidhura me qeverine per transakcionet e tyre me qeverine dhe me shoqerite e tjera te lidhura me te. Shoqeria aktualisht po implementon sisteme per te kapur informacionin e nevojshem. Prandaj, nuk eshte e mundshme ne kete faze te percaktohet impakti i standardit te rishikuar mbi shenimet shpjeguese mbi palet e lidhura, nese ka ndonje te tille.
- 'Klasifikimi i te drejtave te perparemise se nenshkrimin (rights issue)' (amendim i SNK 32), botuar ne tetor 2009. Ndryshimi eshte i aplikueshem per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas 1 shkurtit 2010. Aplikimi me i hershem eshte i lejuar. Ndryshimi shpjegon trajtimin kontabel te te drejtave te perparemise se nenshkrimin te shprehura ne monedhe te ndryshme nga monedha funksionale e emetuesit. Nese disa kushte te caktuara plotesohen, te drejta te tilla te perparemise ne nenshkrim tani klasifikohen si kapital pavaresisht monedhes ne te cilen shprehet çmimi i ushtrimit te tyre. Me pare keto te drejta trajtoheshin si detyrime derivateve. Ndryshimi eshte i aplikueshem ne retrospektive ne perputhje me SNK 8 'Politikat kontabel, ndryshimet ne vleresimet kontabel dhe gabimet'. Zbatimi i ketij ndryshimi nuk eshte relevant per Shoqerine.
- KIRFN 19, 'Shlyerja e detyrimeve financiare me instrumenta kapitali', ne fuqi prej 1 korrikut 2010. Interpretimi qarteson trajtimin kontabel nga nje shoqeri kur termat e nje detyrimi financiar rinegociohen dhe rezultojne ne leshimin nga shoqeria te instrumenteve te kapitalit ndaj nje kreditori te saj per te shlyer nje pjese apo te tere detyrimin financiar (borxh per kontrata kapitali swap).
Kerkohet qe nje fitim apo humbje, qe do te matet si difference midis vleres se mbetur te detyrimit financiar dhe vleres se drejte te instrumenteve te emetuara te kapitalit, te njihet ne fitime ose humbje. Nese vlera e drejte e instrumentit te kapitalit nuk mund te matet me besueshmeri, instrumentet e kapitalit duhet te maten per te reflektuar vleren e drejte te detyrimit financiar te shlyer. Shoqeria do te aplikojte interpretimin nga 1 janari 2011. Nuk pritet te kete ndonje impakt ne pasqyrat financiare te Shoqerise.
- 'Parapagimet per kerkesat e financimeve minimale' (amendime ne KIRFN 14). Ndryshimet korrigojne nje rrjedhoje te pa synuar te KIRFN 14, 'SNK 19 – Kufiri per aktivin e perfitimeve te percaktuara te pensionit, kerkesat e financimit minimal dhe nderveprimi i tyre'. Pa ndryshimet, shoqerive nuk u lejohet te njohin si aktiv disa parapagime vullnetare per kontributet e financimit minimal. Kjo nuk synohet kur KIRFN 14 u publikua, dhe ndryshimet korrigjuan kete. Ndryshimet jane ne fuqi per periudhat vjetore qe fillojne me 1 janar 2011. Aplikimi me i hershem eshte i lejueshem. Ndryshimet duhet te aplikohen ne

3 Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

3.2 Standarde te reja dhe interpretime (vazhdim)

retrospektive deri ne periudhen me te hershme te krahasueshme te paraqitur. Kompania do te aplikojte keto ndryshime per periudhat financiare te raportimit qe fillojne me 1 janar 2011. Sidoqofte nuk pritet te kene ndikim ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

3.3 Transaksionet ne monedhe te huaj

Monedha funksionale dhe raportuese

Vlerat e perfshira ne pasqyrat financiare te Shoqerise maten duke perdorur monedhen e mjedisit ekonomik kryesor ne te cilin operon njesia ('monedha funksionale'). Pasqyrat financiare jane paraqitur ne Lek shqiptar ('Lek') e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e Shoqerise.

Transaksionet dhe balancat

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhe funksionale duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit ose te vleresimit kur njesite jane ri-matur. Fitimi ose humbja nga kembimet qe rezulton nga transaksione te tilla dhe nga konvertimi ne monedhe funksionale ne fund te vitit te aktiveve dhe detyrimeve monetare ne monedhe te huaj njihet ne fitime ose humbje.

Fitimet dhe humbjet nga kembimet valutore qe lidhen me huate, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre paraqiten ne pasqyren e te ardhurave gjithperفشirese ne 'Te ardhura (shpenzime) financiare -neto'. Te gjitha fitimet dhe humbjet e tjera nga kembimet valutore paraqiten ne pasqyren e te ardhurave gjithperفشirese ne 'Te ardhura (shpenzime) te tjera, neto'.

Me poshte paraqiten kurset e rendesishme te kembimit ne Lek per njesi te monedhes se huaj ne daten e raportimit:

	31 December 2010	31 December 2009
Euro	138.77	137.96
Dollari amerikan ("USD")	104.00	95.81
Paundi britanik ("GBP")	161.46	154.64

3.4 Aktive jo-materiale

Modeli i aktiveve jo-materiale

Sipas Marreveshjes se Konçesionit, Shoqeria duhet te pajise me karta identiteti dhe pasaporta te gjitheshtetasit shqiptare. Autoriteti kontrollon dhe rregullon sherbimet qe Shoqeria ofron, ndaj kujt i ofron dhe me çfare çmimi. Autoriteti gjithashtu kontrollon çdo interes te rendesishem ne infrastrukturen e dhene Shoqerise ose te blera nga kjo e fundit per qellime te ofrimit te sherbimeve sipas Marreveshjes se Konçesionit.

Meqenese Marreveshja e Konçesionit ploteson perkufizimin e marreveshjes se konçesionit sipas KINRF 12, Shoqeria ka aplikuar kerkesat e KINRF 12 mbi kete transaksion.

Shoqeria ka zbatuar modelin e aktiveve jo-materiale sipas KINRF 12. Ne lidhje me te drejten e saj per te ngarkuar perdoruesit e sherbimeve publike te meposhtme:

- a) Pajisjen me karta identiteti dhe pasaporta ne Republiken e Shqiperise sipas Marreveshjes se Konçesionit,
- b) Pajisjen me Dokumenta Identifikimi ne Zyrat e Aplikimit ne zyrat konsullore/ambasadat e Republikes se Shqiperise ne vendet e huaja sipas Amendimit,
- c) Ofrimin e Sherbimeve me Procedure te Pershpejtuar sipas Amendimit.

3 Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

3.4 Aktive jo - materiale (vazhdim)

Shoqeria nje aktiv jo-material ne masen e te drejtes se fituar per ngarkimin e perdoruesve te sherbimit publik. Te gjitha aktivet e perdorura nga Shoqeria njihen ne fillim si aktive jo materiale me vleren e drejte te pageses ose detyrimet te pagueshem per to dhe vleren e drejte te aktiveve jo monetare te dhena ne shkembim per konçesionin.

Makineri dhe pajisje te blera, rinovimet dhe te tjera shpenzime

Aktivt jo-materiale perfshijne vleren e paguar per pajisjet e blera dhe per rinovimet e aktiveve te dhena nga Autoriteti. Shpenzimet e tjera ne lidhje me aktivt jo-materiale qe rezultojne nga Marreveshja e Konçesionit njihen ne shumen e mbartur te aktiveve jo-materiale.

Tarifa te pagueshme ndaj Autoritetit

Shoqeria detyrohet t'i paguaje Autoritetit per çdo vit financiar nje tarife ("Tarifa e Konçesionit") ne masen 5% te totalit te qarkullimit vjetor (para aplikimit te TVSH-se) te kartave te identitetit per te drejtat dhe privilegjet e dhena ne Marreveshjen e Konçesionit duke u bazuar ne shifrat e paraqitura ne pasqyrat financiare te audituara te Shoqerise. Tarifa e Konçesionit lind ne baze te perdorimit te sherbimeve nga publiku dhe nuk eshte nje e drejte e pakushtezuar per te marre para. Rrjedhimisht, Tarifa e Konçesionit e pagueshme ndaj Autoritetit njihet kur sherbimet perfitoen nga perdoruesit.

Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes ne lidhje me aktive te kualifikuara kapitalizohen si pjese e kostos se aktivit.

Amortizimi

Aktivt jo-materiale kane nje jete te dobishme te percaktuar e cila perfundon ne fund te Marreveshjes se Konçesionit qe eshte data 31 korrik 2013 dhe njihen me vleren historike duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin e akumuluar.

Shoqeria amortizon aktivt jo-materiale duke perdorur metoden lineare mbi jeten e dobishme te aktivit te patrupezuar duke filluar qe nga data kur aktivt eshte i gatshem per perdorim. Jetet e dobishme te perlllogaritura per periudhen aktuale jane si me poshte:

Permiresime ne qiramarrje

Shpenzime rinovimi

Makineri dhe Pajisje

Software

Pajisje IT dhe aktive te tjera

Me e shkurtera mes kohezgjatjes se qirase dhe periudhes se konçesionit

Periudha e konçesionit

Periudha e konçesionit

Periudha e konçesionit

Periudha e konçesionit

Metoda e amortizimit dhe jeta e dobishme e aktiveve rishikohen dhe rivleresohen ne fund te çdo periudhe raportimi.

3.5 Zhvleresimi i aktiveve jo-financiare

Aktivt qe kane nje jete te pacaktuar nuk jane subjekt amortizimi dhe testohen çdo vit per zhvleresim. Aktivt qe jane subjekt amortizimi rishikohen per zhvleresim sa here qe ka ngjarje ose ndryshime ne rrethana te cilat tregojne se vlera e mbartur e tyre nuk mund te jete e rikuperueshme.

Nje humbje nga zhvleresimi njihet per vleren me te cilen vlera e mbetur e nje aktivt tejkalon vleren e tij te rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme eshte vlera me e larte midis vleres se drejte te nje aktivt pas zbritjes se shpenzimeve te shitjes dhe vleres ne perdorim te tij.

Per qellime te percaktimit te zhvleresimit, aktivt grupohen ne nivelet me te uleta nga te cilat mund te identifkohen flukse monetare te veçanta (njesi gjeneruese te parase).

3 Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

3.6 Instrumenta financiare

Shoqeria mban vetem instrumentat financiare jo-derivative perfshire llogari e te tjera te arketueshme, mjete monetare dhe ekuivalente te tyre, hua te marra e te dhena dhe llogari e te tjera te pagueshme.

Shoqeria i klasifikon aktivet e saj financiare vetem ne kategorite e huave dhe te arketueshmeve.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus kostot e transaksioneve qe lidhen me to, per instrumentat jo me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes, pervec siç pershkruhet me poshte.

Ne vijim te njohjes fillestare, instrumentat financiare jo-derivative te klasifikuar si hua dhe te arketueshme maten si diference e kostos se amortizuar me humbjet nga zhvleresimi.

Nje instrument financiar njihet nese shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te shoqerise mbi flukset e parase se aktivitet financiar ose kur shoqeria transferon aktivin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente

Mjetet monetare dhe te tjera ekuivalente perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat dhe investime te tjera likuide me maturim jo me te gjate se 3 muaj.

Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar njihen fillimisht me vlere te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjet nga zhvleresimi.

Modeli i aktiveve financiare

Sipas Amendimit te Marreveshjes se Konçesionit (shenimi 1.2) Shoqeria do te rimburohet nga Autoriteti per sherbimet e meposhtme:

- a) Dizenjimin, ngritjen, zhvillimin, implementimin dhe operimin e Sistemit per rritjen e kapacitetit te prodhimit dhe shperndarjes se pasaportave ne perputhje me specifikimet e Amendimit.
- b) Dizenjimin, ngritjen, zhvillimin, implementimin dhe operimin e Sistemit per pajisjen me Dokumenta Identifikimi per Emigrantet ne perputhje me specifikimet e Amendimit.

Kompensimi i dhene nga Autoriteti ne lidhje me sherbimet e lartpermendura sjell lindjen e nje aktivitet financiar ne baze te KINRF 12, i cili njihet fillimisht me vleren e drejte te shumes se arketuar per sherbimet e ofruara / qe do te ofrohen.

Ky aktiv financiar kompensohet me pas me detyrimin financiar ndaj Autoritetit meqenese Shoqeria ka te drejten ligjore per te kompensuar shumen e arketueshme nga Autoriteti, sic parashikohet ne Amendimin e Marreveshjes se Konçesionit, me tarifen e pagueshme te konçesionit ndaj Autoritetit.

Detyrime per t'u paguar

Detyrimet per t'u paguar paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar.

Hua te marra dhe te dhena

Huate e marra dhe te dhena njihen fillimisht me vleren e drejte. Pas njohjes fillestare, huate e marra dhe te dhena paraqiten me kosto te amortizuar duke njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve çdo diference midis koston dhe vleres se pagueshme nominale pergjate periudhes se huamarrjes duke u bazuar ne metodën e interesit efektiv.

Huate klasifikohen si detyrime afatshkurtra me perjashtim te rastit kur Shoqeria ka nje te drejte te pakushtezuar te shtyje shlyerjen e detyrimit per te pakten 12 muaj pas dates se raportimit.

3 Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

3.6 Instrumenta financiare (vazhdim)

Tarifat e pagueshme ndaj Autoritetit

Tarifat e pagueshme ndaj Autoritetit regjistrohen si detyrim financiar kur sherbimet i ofrohen perdoruesve. Ato maten me vleren e drejte te pagueshme tek Autoriteti ashtu siç shpjegohet ne shenimin shpjegues 3.4.

Te tjera

Instrumenta te tjere financiare jo-derivative maten me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv minus humbjet nga zhvleresimi.

Instrumentat financiare klasifikohen si detyrime afatshkurtra me perjashtim te rastit kur Shoqeria ka nje te drejte te pakushtezuar te shtyje shlyerjen e detyrimit per te pakten 12 muaj pas dates se raportimit.

3.7 Zhvleresimi i aktiveve financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet i zhvleresuar nese ka te dhena objektive qe tregojne se nje apo disa ngjarje kane efekte negative ne flukset e ardhshme monetare qe parashikohet te gjenerohen nga aktivi. Humbja nga zhvleresimi i nje aktivi financiar te matur me kosto te amortizuar llogaritet si diference midis vleres kontabel neto te aktivitetit dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktive financiare te rendesishme testohen per zhvleresim individualisht. Aktivitetet e tjera financiare vleresohen kolektivisht, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te rrezikut kreditor. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me nje aktiv financiar i disponueshem per shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet ne shpenzime. Nje humbje nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Per aktivitetet financiare te matura me kosto te amortizuar rimarrja njihet ne fitime ose humbje.

3.8 Inventaret

Inventaret paraqiten me nje vlere te barabarte me me te ulten midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Kosto percaktohet me metoden mesatare dhe perfshin materiale te para, punen direkte, kosto te tjera direkte dhe shpenzime te tjera te lidhura. Vlera neto e realizueshme eshte cmimi fikse i shitjes siç eshte percaktuar ne Marreveshjen e Konçesionit duke i zbritur shpenzimet variabël te shitjes.

3.9 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqerise njihet me vleren nominale.

3.10 Tatim fitimi aktual dhe i shtyre

Shpenzimet tatimore te periudhes perfshijne tatimin aktual dhe ate te shtyre. Tatimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me perjashtim te rasteve kur ai lidhet me zera te njohur direkt ne kapitalet e veta. Ne keto raste tatimi njihet gjithashtu ne kapital.

Detyrimi aktual per tatim fitimin llogaritet mbi bazen e ligjeve tatimore te dekretuara ose pjeserisht te dekretuara ne daten e raportimit. Drejtuesit vleresojne ne menyre periodike pozicionin e Shoqerise sipas deklarave tatimore ne lidhje me situata ne te cilat ligjet tatimore kane nevoje per interpretime. Drejtuesit perlllogarisin aty ku eshte e nevojshme provizione mbi bazen e shumave qe pritet t'u paguhen autoriteteve tatimore.

Tatim fitimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e detyrimeve, mbi diferenca te perkohshme qe lindin nga baza tatimore e aktiveve dhe detyrimeve dhe vleres se tyre kontabel te mbartur ne pasqyrat financiare.

3 Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

3.10 Tatim fitimi aktual dhe i shtyre (vazhdim)

